



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**



**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

## **Dëgjimi publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026 – Fshati Orllan**

Dëgjimi publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026, u mbajt në fshatin Orllan, ku diskutimi u hap nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Leutrim Krasniqi, duke bërë krahasimin e buxhetit të vitit 2023 me atë të vitit 2024, i cili është 4 milion euro më shumë se i vitit 2023.

Arsyeja e debatit publik ishte diskutimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2024-2026, ku bashkë me Drejtorin Krasniqi ishin edhe Drejtori i Bujqësisë, Fatmir Rudari dhe Drejtori i Zhvillimit Ekonomik, Vigan Salihu.

Drejtori Krasniqi, theksoi se si institucion Komunal për vitin 2024/2026 rëndësi i kemi kushtuar sektorit të arsimit, shëndetësisë, bujqësisë dhe infrastrukturës, por pa lënë anash edhe sektoret të tjera që janë në shërbim të qytetarëve. Ku, theksoi se në sektorin e arsimit kanë filluar, me përmirësimin e kushteve për nxënësit, ndërtimin e çerdheve të reja, ndertimin e shkollës ekonomike në qytet, etj. Kurse, në shëndetësisë është ndërtimi i Urgjencës së qytetit që është një projekt milionësh, përmirësimi i kushteve shëndetësore për të gjitha pikat e QKMF-ve. Në bujqësi kemi pasur rritje të subvencioneve, kemi përkrahur bujqit dhe në infrastrukturë kemi pasur trajtim të veçantë në kuadër të qytetit, ku gjatë këtij viti prioritet ka qenë rruga “Skenderbeu”, ndërsa vitin e ardhshëm do të vazhdojmë me rrugën “Xhemajl Mustafa” e shumë të tjera.

Gjithashtu, Drejtori Krasniqi tha është projekt i rëndësishëm edhe projekti 2 vjeçar, ku për vitin 2024 parashihet shtrirja e kolektorit për ujrë të zeza, ku poashtu është një projekt milionësh.

Për zonën e Orllanit, Drejtori Krasniqi shtoi se i kemi kushtuar rëndësi më të madhe sektorit të infrastrukturës, ku tashmë kemi filluar me trajtimin e rrugës së Turuqicës, ku do të vazhdojë edhe rruga e fshatit Kalaticë. Po ashtu, Drejtori shtoi se e rëndësishme të përmendet është edhe nënshkrimi i memorandumit për ndërtimin e rrugës nga Kulla e Zahir Pajazitit deri tek Xehrorja, ku është në funksion lidhës për këtë rajon.

Ali Sekiraqa, banorë i zonës së Orllanit- U shpreh i pakënaqur me mospërfilljen e kahmshme për asfaltimin e rrugës Kodër-Metërgofc dhe kërkoi nga drejtorët që ishin prezent të paktën të bëhet rrugë e kalueshme të këtij vit dhe pastaj të shqyrtohet për të hyrë në buxhet për dy vitet e ardhshme.

Avni Zeka, banorë i zonës së Orllanit- Gjithashtu, ky banor e kishte kërkesën e njejt për asfaltimin e rrugës lidhëse Kodër Metërgofc dhe kërkoi për shtrirjen e ujësjellit apo ujit të pijës në atë zonë.

Bahri Retkoceri, banorë i fshatit Bllatë- U shpreh i pakënaqur me mospërfilljen e kahmotshme për kërkesën e asfaltimit të rrugës në fshatin Bllatë, ku tha se për shkak që rruga është e pakalueshme nuk po mundemi as tokën të punojmë.

Naim Bajrami, banorë i fshatit Orllan dhe Drejtor i shkollës së Orllanit- Shprehi pakënaqësi për shkollën e Orllanit, e cila është në gjendje jo të mirë për zhvillimin e mësimt në ato klasë dhe kërkoi nga drejtorët në renovimin e çatisë së shkollës sepse kur ka reshje atmosferike, uji depërton në klasë dhe krijon probleme në zhvillimin e mësimt. Po ashtu, kërkoi nga Komuna në ndërtimin e një fushe të sportit në oborrin e shkollës.

Milaz Haliti, banorë i fshatit Kushevicë- Shprehi pakënaqësit për mosasfaltimin e kahmotshme të rrugës së fshatit Kushevicë që është rrugë lidhëse për fshatin Nishefc dhe Keqekollë.

Ragip Sherifi, banorë i fshatit Brainë- Kërkoi nga drejtorët që të merret parasysh kërkesa për asfaltimin e një rruge anësore të fshatit Brainë, më saktë në lagjen Quku.

Samir Xhela, banorë i fshatit Brainë- Kërkon nga Komuna për asfaltimin e rrugës “Remzi Fetahu” dhe “Ismajl Xhela”, në fshatin Brainë dhe po ashtu ka kërkuar të vendos shenja në rrugë, për të treguar se është shkolla afër dhe ka nxënës në rrugë dhe të vendosen polic të vdekur në rrugë afër shkollës së Bërvenikut.

Ramadan Hyseni, banorë i fshatit Brainë- Kërkon nga Komuna që të asfaltohen edhe lagjet ku janë të banueshme me banorë, përveç rrugës kryesore të Brainës.

Samed Rexhepi, banorë i fshatit Muhazob- Kërkon nga Komuna rregullimi i kanalizimit në rrugën që është shtruar me zhavor në vitin e kalur dhe gjithashtu ka kërkesë për mbulimin me energji elektrike në atë rrugë.

Faik, banorë i fshatit Orllan- Kërkon nga Komuna asfaltimin e rrugëve anësore që janë të banueshme, rregullimin e çatisë së shkollës së Orllanit, furnizimin e banorëve me ujë të pijes dhe rregullimin e çështjes së kanalizimit.

Avni Avdiu, banorë i fshatit Orllan- Kërkon nga Komuna të ndërtohet salla e sportit në shkollën e Orllanit, zgjerimi i urës në fshatin Orllan dhe të rregullohet një kend i lojrave për fëmijët e Orllanit.

Drejtori Krasniqi tregon se rruga e fshatit Bllatë dhe te disa fshatrave të tjera do të trajtohen fillimisht me zhavor dhe pastaj do të përfundohen në këtë vit ose vitin tjetër.

Po ashtu, thekson se në Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2024 parashihet përmirësim në infrastrukturën shkollore në vlerë prej 400mijë euro. Gjithashtu, për sallat e sportit drejtori Krasniqi tregon se në KAB parashihen 200mijë euro për rregullimin dhe ndërtimin e sallave të sportit.

Ndërsa, sa i përket rrugës Kushevicë që është rrugë lidhëse për fshatin Nishefc dhe Keqekollë, drejtori Krasniqi ka treguar se është bërë një marrëveshje me Ministrin e Infrasturkutës që asfaltimi i kësaj rruge do të mbetet në kuadër të buxhetit të Ministrisë se Infrastrukturës për vitin 2024, ku ka theksuar se tashmë është duke përgatitur kërkesat për t'i dorëzuar në MI.

Për rrugicat anësore të fshatit Brainë, drejtori Krasniqi ka treguar se fillimisht janë duke asfaltuar vetëm segmentin kryesor apo rrugën kryesore të këtij fshati, kurse rrugicat anësore do të shtrohen me zhavor dhe vitin tjetër do të asfaltohen, gjithashtu shtoi se mundësia si institucion është më e vogël se sa kërkesat që janë nga qytetarët, por jemi duke bashkëpunuar edhe me institucionet qendrore për plotësimin e kërkesave.

Ndërsa, sa i përket rrugës së fshatit Muhazob që është trajtuar më zhavor, drejtori Krasniqi theksoi se nëse rruga është e dëmtuar në ndonjë pjesë të caktuar, atëherë do ta trajtojmë edhe një herë, sepse pjesë e kontratës është edhe garancioni i cili kompania duhet ta kontrollojë rrugën për një periudhë të caktuar. Ndërkaq, për energji elektrike drejtori Krasniqi ka thënë se jemi duke u munduar si institucion komunal të dakordohemi me KEDS-in për çdo kërkesë të qytetarëve, por që përcaktimi se kur të përfundojnë punime për furnizim me energji elektrike varen nga KEDS-i.

Drejtori Krasniqi për ujin e pijës në Orllan dhe impiantin ka thënë se si Komune i kemi dhënë prioritet mjaft të madh, ku Komuna ka biseduar me Ambasadën Zvicrrane dhe kompanin e cila ka qenë e kontraktuar për kthimin apo rikuperimin në gjendjen normale të impiantit. Ndërsa, për pjesën e shkollës së Orllanit e dim që nuk është e përfshirë në impiant, e në kuadër të kësaj drejtori Krasniqi tha se do të mbajmë një takim me nivelin qendror për shqyrtimin e përfshirjes së shkollës në impiant.

Për ujin e pijes drejtori Krasniqi shtoi se Komuna, Ministria dhe KRU Prishtina kanë filluar iniciativën për furnizim me ujë të pijes për të gjithë banorët e zonës së Orllanit, e që tashmë është në fazën e marrjes së një pëlqimi nga KEDS-i për të vazhduar me shtrirjen e rrjetit për komplet zonën e Orllanit.

Drejtori Krasniqi në fund të debatit i falënderoi banorët e fshatit për pjesëmarrjen në debat dhe deklaroi se të gjitha sygjerimet dhe kërkesat që u bënë gjatë këtij debati janë evidentuar, ku të gjitha do të adresohen në drejtoritë përkatëse, do t'i shqyrtohen dhe do të angazhohemi në përfshirjen e tyre në buxhet për vitin 2024.

**02 qershor, fshati Orllan**



Hapu, hapu, e rrëzë!  
Pa jokë tohu, o drutë!  
Je soviti këth' e mirë!  
U gëthi nata u bëditë!



Je ardhje këtu  
U jepi nota u bë ditë.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Debat Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026 (KAB), banorët e fshatit  
Orllan dhe fshatrave përreth.

Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrëseve:

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	Fajk Hotba	Orllan	[Signature]
2	Ali Selajevci	Bllacë	[Signature]
3	AMR ZERA	KODER MAHALI	[Signature]
4	Baki Kelmaj	Bllacë	[Signature]
5	Fehri Redoxhi	Bllacë	[Signature]
6	ILAZ HALITI	KUSHEVIC	[Signature]
7	Hedra Ghenji	Braimë	[Signature]
8	Ramu den Kren	BRAIMË	[Signature]
9	Raqip Ghenji	Braimë	[Signature]
10	SAMIR XHCLP	BRAIME	[Signature]
11	SAMED REXHEPI	MUHARZOR	[Signature]
12	Johnin Ruzicani	Orllan	[Signature]
13	AVDI AVDIU	ORLLAN	[Signature]
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			

22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			

Vërejtje: Nënshkruhen të gjithë ata persona të cilët pajtohen që të dhënat e tyre dhe foto mund të përdoren për publikim e procesit të konsultimeve në ueb faqen zyrtare të Kom Podujevës.

Podujevë  
02.06.2023